



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 82/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nenad Lazic kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik Nisma Për Kosovën, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) lidhur me mos emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV-së) nga ky subjekt politik në komunën Prizrenit, në seancën e panelit të mbajtur me 30.05.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Nisma Për Kosovën, dega në Prizren

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një apel nga subjekti politik Nisma Për Kosovën paraqitur kundër KQZ-së, lidhur me mos emërimin e anëtarëve dhe kryesuesve të KVV-ve në komunën e Prizrenit, ku sipas parashtrësies të ankesës se me datën 29.05.2014 në ora 10:00 nga zyrtari ekzekutiv i KQZ-së në Prizren verbalisht janë njoftuar se nuk ju është pranuar asnjë anëtar i këshillave të vendvotimeve nga Nisma pa asnjë arsyetim me shkrim. Pretenduesi i ankesës ka theksuar se ka biseduar me Drejtorin e Zyrës Ligjore në KQZ, Xhemail Peqani i cili ju ka përgjigjur se nuk ju ka lëshuar vendim me shkrim. Po ashtu pretenduesi i ankesës thotë se me datën 19.05.2014 kanë dërguar një shkresë në KQZ për përfaqësim sipas LZP-së për anëtar në KVV por siç është cekur në ankesë nuk ju është ofruar përgjigje edhe pas nominimit të tyre. Sipas parashtrësies të ankesës është bërë shkelja e nenit 76 pika 3 dhe neni 74 pika 1 dhe kërkojnë nga PZAP-i që ta udhëzojë KQZ-në ta rishqyrtoj certifikimin e nominimeve të anëtarëve të KVV-së të Nismës Për Kosovën, dega në Prizren, ku siç theksojnë se në bazë të nenit 122.2 të LZP-së, KQZ-ja nuk ishte e arsyeshme në marrjen parasysh të rrethanave dhe të neneve të lartpërmendura.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në më datën 29.05.2014, për apelin që është bërë ndaj KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit deri më datë 30.05.2014 deri në ora 10:00. PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja, në të cilën theksohet se me vendimin nr.1027 të datës 27.05.2014 KQZ ka emëruar Këshillat e Vendvotimeve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të datës 8 Qershor 2014 dhe

me dispozitat e nenit 63.6 të LZP-së shprehimisht është përcaktuar se “ Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qartë me këtë ligj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **apeli është i pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore për mos e emërimin e anëtarëve të KVV-së nga subjektit politik Nisma Për Kosovën në Komunën e Prizrenit, nuk qëndrojnë pasi në bazë të shkresave të lëndës të ofruar nga pala nuk mund të vërtetohet shkelja e pretenduar në ankesë për mos certifikimin e nominimeve të anëtarëve të KVV-së të këtij subjekti. PZAP-i në munges të provave, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 lidhur me neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 82/2014 më datën 30.05.2014.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Nenad Lazic**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*